



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 6413/1 Prot.

Lezhë, më 26 . 05 . 2026

PROJEKT-VENDIM

PËR
DHËNIEN E MANDATIT SI ANËTARE E KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË
ZJ. ELSUIDA PREND PRENDI

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 49, neni 54 dhe neni 55, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Lezhë:

Propozon:

1. Dhënie e mandatit si anëtare e Këshillit të Bashkisë Lezhë zj. Elsuida Prend Prendi, sipas vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 30, datë 7.5.2026 “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumëpartiake e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Elsuida Prend Prendi”, përcjellë me shkresën me nr. Prot. 1125, datë 08.05.2026 “Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënie e mandatit”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
Protokolli
Kartelë shoqëruese e praktikës

I. Dërgues K Q Z
Nr. 1125 Prot., Datë 8 / 5 /2026

II. Marrësi : Bashkia Lezhë Nr. 6413 Prot., Datë 11 / 5 /2026
Përmbajtja : Moglim për dhënie mandati

III. Për t/u trajtuar nga : 1. K. Bashkia Datë 1 / 1 /2026
2. _____

Shënim i Kryetarit _____

Afati kthimit të përgjigjes: 7 ditë 5 ditë 3 ditë 2 ditë Urgjent (brenda ditës)

Firmë _____

IV. Marrë në dorëzim nga Drejtori Drejtorisë përkatëse _____, Datë _____ /2026
V. Për t/u trajtuar nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës _____, Datë 1 / 1 /2026
Shënim i Drejtorit të Drejtorisë: _____

Firmë _____

VI. Marrë në dorëzim nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës _____, Datë _____ /2026
VII. Për t/u trajtuar nga Specialisti i Sektorit përkatës _____, Datë _____ /2026
Shënim i Përgjegjësit të Sektorit: _____

Firmë _____

VIII. Marrë në dorëzim nga Specialisti i Sektorit përkatës _____, Datë _____ /2026
Firmë _____

IX. Dorëzim i Eprorit porosites, Datë _____ / _____ /2026
X. Shënim _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 08/05/2026

Nr. 1125

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë-Lezhë
Lagjia "Skanderbeg", Sheshi "Gjergj Lastrioti", 4501, Lezhë.

Partisë Socialiste të Shqipërisë
Sheshi "Austria", Nr. 91, Tiranë.

Zj. Elsuida Prend Prendi
Ballëdren i Ri, Ndërtesa 29, H. 1, 4504 Lezhë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 07.05.2026 vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", zj. Elsuida Prend Prendi.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 30, datë 07.05.2026.

Duke ju falënderuar,

Sekretar i Përgjithshëm

(në mungesë dhe me urdhër)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 7.5.2026

Nr: 30

Ora: 13:30

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË LEZHË ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË", ZJ. ELSUIDA PREND PRENDI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3930 prot., datë 26.03.2026, Këshilli i Bashkisë Lezhë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Rajmonda Aleksander Prendaj, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", për Këshillin e Bashkisë Lezhë të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 11, zj. Elsuida Prend Prendi.

Me shkresën nr. 795, prot., datë 02.04.2026, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatis për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, zj. Elsuida Prend Prendi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit "Partia Socialiste e Shqipërisë" ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër LE-PS-3067_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin,

Data: 7.5.2026 Nr: 30
Ora: 13:30



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", zj. Elsuida Prend Prendi"

verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Elsuida Prend Prendi, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 892 prot., datë 16.04.2026, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 893 prot., datë 16.04.2026, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zj. Elsuida Prend Prendi.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Elsuida Prend Prendi në Këshillin e Bashkisë Lezhë.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 7208/1 prot., datë 23.04.2026, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Elsuida Prend Prendi, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Elsuida Prend Prendi, në Këshillin e Bashkisë Lezhë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.


PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemënore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", zj. Elsuida Prend Prendi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



Data: 7.5.2026 Nr: 30
Ora: 13:30



Nr. Prot - 1116

At. 07.05.2026